



Prishtinë, 15 tetor 2018  
Kodi i ZRRE: V\_1049\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 9, Neni 13 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT); dhe
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 9 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);

në seancën e mbajtur më 15 tetor 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHET** – Faktori i Efikasitetit i lejuar për periudhën e dytë rregullative 1 prill 2018- 31 mars 2023 për OST/OT dhe OSSH.
- II. OBLIGOHET** - Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për zbatimin e këtij vendimi për periudhën e dytë rregullative 01 prill 2018- 31 mars 2023.
- III.** Përshtatjet për nivelin e faktorit të efikasitetit në baza vjetore sipas këtij vendimi do të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve vjetore.
- IV.** Faktori i Efikasitetit i lejuar për OST/OT dhe OSSH për periudhën e dytë rregullative sipas dispozitivit nën pikën I të këtij vendimi, është dhënë në tabelën në vijim:

*Tabela 1 – Faktori i Efikasiteti i lejuara për periudhën e dytë rregullative*

Faktori i Efikasitetit	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Operatori i Sistemit Operatori i Tregut OST/OT	%	-	1.50	1.50	1.50	1.50
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH	%	-	1.50	1.50	1.50	1.50

## ARSYETIM

ZRRE në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me legjislacionin e cekur në hyrje të këtij Vendimi, e lidhur me vendosjen e faktorit të efikasitetit ka zhvilluar një proces transparent, ku është përfshirë edhe konsultimi me palët e interesit:

- Rregullatori më datë 15 maj 2017 ka iniciuar shqyrtimin e dytë të periudhës rregullative (prill 2018- 2022);
- Raporti Konsultativ – Faktori i Efikasitetit, i publikuar më 24 gusht 2018;
- Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OST/OT, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
- Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Shqyrtimi Periodik për OSSH, i publikuar me datën 24 gusht 2018;
- Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale OST/OT – Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
- Raport Përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale OSSH– Përgjigjet ndaj Komenteve, i publikuar me datën 24 shtator 2018;
- ZRRE-ja do të aplikon faktorin e efikasitetit në “Shpenzimet Operative Bazë” që përfshijnë kostot personelit, kostot e mirëmbajtjes dhe shpenzimet tjera të përgjithshme operative. Përfshihet kostot e blerjes së energjisë për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike në rrjet, kostot e zhvlerësimit, kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse dhe të blerjes së shërbimeve tjera etj., dhe
- Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**




Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe
- Kompanisë Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)
- Arkivit të ZRRE-së.